

Shpallje e konferencës shkencore ndërkombëtare dhe thirrje për autorët për bashkëpunim



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E TREGTISË  
DHE INDUSTRIË

Kolegji Universitar “Pjetër Budi” dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

***MENAXHIMI I RESURSEVE EKONOMIKE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT TË  
VENDEVE NË TRANZICION***

**23 – 24. 05. 2013**

Prishtinë, Kosovë

Kolegji Universitar “Pjetër Budi” në Prishtinë këtë vit shënon nëntëvjetorin e ekzistimit në lëmin e turizmit, doganës, menaxhimit dhe sigurimeve në Kosovë. Kolegji do ta shënojë këtë jubile në mënyrë solemne dhe me aktivitete punuese, duke organizuar konferencë shkencore ndërkombëtar në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë-Departamenti i Turizmit.

Konferenca shkencore është e hapur për hulumtuesit të cilët merren me teorinë dhe praktikën e menaxhimit të resurseve ekonomike, si dhe për ekspertët – përfaqësues të ndërmarrjeve hoteliere – turistike, të industrisë së sigurimeve, doganës etj.

Regjistrimi i pjesëmarrësve, hapja e takimit, seanca plenare dhe veprimtaria sipas seksioneve do të organizohet në Prishtinë. Mirëpresim kontributet dhe bashkëpunimin tuaj.

**Temat e konferencës ndërkombëtare:**

1. Menaxhimi në turizëm dhe hoteleri
2. Menaxhimi në industrinë e sigurimeve
3. Menaxhimi në doganë e shpedicion
4. Menaxhimi dhe marketingu
5. Edukimi dhe gjuhët e huaja në turizëm, hoteleri, sigurime, doganë
6. Trendet në menaxhim
7. Investimet e huaja në funksion të zhvillimit
8. Menaxhimi i resurseve njerëzore
9. Kontrolli financiar
10. Marketingu ndërkombëtar
11. Menaxhimi dhe administrimi i bizneseve
12. Menaxhimi i bizneseve të vogla dhe të mesme

13. Menaxhimi i investimeve
14. Bankat dhe financat
15. Menaxhimi i sistemeve informative

### **Mënyra e paraqitjes së kontributeve:**

Këshilli shkencor do t'i pranojë punimet të cilat mund të përfshihen në seksionet e propozuara. Abstrakti i punimit (më së shumti 100 fjalë) në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze duhet të dorëzohet nëpërmjet postës elektronike (e-mail) në adresën [pjeterbudi@gmail.com](mailto:pjeterbudi@gmail.com). Gjuhët zyrtare të konferencës ndërkombëtare shkencore janë gjuhët shqip, serbisht dhe anglisht.

### **Botimi i abstrakteve dhe punimeve të ekspozuara në konferencën shkencore ndërkombëtare:**

Abstraktet do të botohen në koleksionin e abstrakteve, ndërsa punimet në CD, të cilat do t'u shpërndahen pjesëmarrësve të konferencës shkencore gjatë regjistrimit.

### **Mënyra e pjesëmarrjes në prezantimin e punimeve:**

Pjesëmarrësit gëzojnë të drejtën e prezantimit deri më 15 minuta me ndihmën e teknikës prezantuese.

### **Vendosja e pjesëmarrësve**

Për detajet dhe kushtet e vendosjes do të njoftoheni më vonë. Për pjesëmarrësit, punimet e të cilëve pranohen nga recensentët, është siguruar akomodimi dhe ushqimi pa pagesë nga ana e organizatorëve. Ndërkaq, për pjesëmarrje në konferencë dhe paraqitjen e punimeve shkencore, paguhet shuma prej 50 eurosh në xhirrollogarinë e Kolegjit Universitar "Pjetër Budi".

Pjesëmarrësit do të kenë në dispozicion më së shumti (maksimum) 15 minuta për prezantimin me gojë të punimit. Është i pëlqyeshëm prezantimi përmes Power Point.

### **Datat dhe afatet e rëndësishme:**

Data e fundit për dorëzimin e abstraktit:	01. 03. 2013
Lajmërimi për pranimin e abstraktit:	15. 03. 2013
Dorëzimi i punimeve:	15. 04. 2013
Koha e mbajtjes së konferencës shkencore:	23 - 24. 05. 2013

### **Vendi i mbajtjes së konferencës shkencore ndërkombëtare:**

**Do të njoftoheni me kohë.**

### **Udhëzimi për përgatitjen e tekstit:**

Teksti i punimit përgatitet në *Microsoft Word* për Windows, fonti *Times New Roman*, *Single Space*.

Dimensionet e faqes:

Gjerësia 12,5cm;

Lartësia 18,5cm;

Formati A4;

Margjinat: e sipërme 6,2cm, e poshtme 5cm, e majta 4,5cm, e djathta 4cm.

Numri i karaktereve së bashku hapësirat nuk duhet të jetë më shumë se 20.000 karaktere (8 faqe).

### **Udhëzim për përpunimin teknik të punimit:**

1. Titulli: fonti 12pt; bold, all caps, center
2. Një rresht i zbrazët 10pt
3. Autorët: 10pt, bold, center
4. Adresa: titulli i institutit, qyteti, shteti (10pt, center)
5. Një rresht i zbrazët 10pt
6. Abstrakti: 10pt, bold, center
7. Një rresht i zbrazët 10pt
8. Teksti i abstraktit: 10pt, tab stop position 0,5, justify
9. Fjalët kyç: deri më pesë
10. Zbrazët 3x10pt
11. Hyrja dhe titulli i secilit kapitull vijues: pa numërim, all caps, centro
12. Një rresht zbrazët 10pt
13. Teksti i punimit 10pt, tab stop position, 0,5, justify
14. Literatura: 10pt, all caps, center
15. Literatura të radhitet sipas alfabetit

### **Draft agjenda e konferencës shkencore**

22.05.2013

Ardhja e pjesëmarrësve

23.05.2013

08:00 – 09:30 Regjistrimi i pjesëmarrësve

09:30 – 10:30 Hapja e konferencës shkencore-ndërkombëtare

10:30 – 11:30 Seancë plenare

11:30 – 12:00 Koktejt

12:00 – 14:00 Puna nëpër seksione

14:00 - 15:30 Dreka e përbashkët

16:00 – 19:00 Puna nëpër seksione

20:30 – 23:00 Darka

24.05.2013

10:00 – 12:30 Tryezë e rumbullakët dhe mbyllja e konferencës shkencore-ndërkombëtare

13:00 – 17:00 Shëtitje

### **INFORMATATA SHITESË**

Për të gjitha informatat shtesë, ju lutemi të na kontaktoni.

Qendra Zhvillimore-Hulumtuese

Kolegji Universitar “Pjetër Budi”

Rruga “Isa Kastrati”, pn.

e-mail: [pjeterbudi@gmail.com](mailto:pjeterbudi@gmail.com)

ose

Personat për kontaktim: Fitim Maqani tel+377 (0) 44 506 490

Imer Mushkolaj tel+377 (0) 44 116 730